



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:244646
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05845171
Ac.nr.7061/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve L.R. dhe F.R., të dy nga V....., të cilët i përfaqëson me autorizim av. Kadri Osaj nga Mitrovica, paditësin G.R. nga V....., të cilin e përfaqëson me autorizim Albina Rama nga Vushtrria, kundër të paditurit H.R. nga V....., të cilin e përfaqëson Gazmend Rama, për shkak të vërtetimit të pronësisë, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri C.nr.512/2018 të datës 15.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e autorizuarit të paditurit H.R. nga V....., dhe **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri, C.nr.512/2018 i datës 15.07.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.512/2018 i datës 15.07.2021, ka vendosur që të:

*“I. VERTETOHET se paditësit L., F. dhe G.R. të gjithë nga Vushtrria, janë pronar mbi bazën e ndarjes se pronës se paluajtshme nga bashkësia familjare e paraardhësve të tyre si ne vijim:
- Paditësi L.R. i pasurisë se paluajtshme dhe atë parcelave kadastrale P-nr.156-12, me sipërfaqe prej 0,37.09 ha, parc.kad. P-157-1, me sipërfaqe prej 0,19.65 ha, parc.kad. P-225-2, me sipërfaqe prej 0,66.52 ha, parc.kad. 226-2 me sipërfaqe prej 0,44.64 ha, parc.kad. 234-2, me sipërfaqe prej 0,07.25 ha, parc.kad. 235-1, me sipërfaqe prej 0,17.76 ha, parc.kad. P-529-3, me sipërfaqe prej 0,32.33 ha, parc.kad. P-619-0, me sipërfaqe prej 0,52.62 ha,*

- Paditësi F.R. i pasurisë se paluajtshme dhe atë parcelave kadastrale P-527-0, me sipërfaqe 0,42.86 ha, parc.kad 529-1, me sipërfaqe 1,32.67 ha, parc.kad P-530-1, me sipërfaqe 0,07.94 ha,
- Paditësi G.R. i pasurisë se paluajtshme dhe atë parcelave kadastrale P-201-0, me sipërfaqe 0,36.56 ha, parc.kad.P-202-0, me sipërfaqe 0,56.35 ha, parc.kad.203-0, me sipërfaqe 0,28.05 ha, parc.kad.P-204-1, me sipërfaqe 0,53.84 ha, parc.kad.204-2, me sipërfaqe 0,43.32 ha, të cilat evidentohen në Çertifikatat e Pronës UL-70202069-0096 ZK/Shallc/Vushtrri, dhe UL-70202069-00009 ZK Shallce/Vushtrri.

II.DETYROHET i padituri H.R. që t'ua njohe të drejtën e pronësisë paditësve sipas pikës I të dispozitivit dhe të njëjtit ti lejoj që ketë të drejtë ta regjistrojnë në librat kadastral në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim iu shërben paditësve si bazë për regjistrimin e të drejtë se pronësisë sipas pikës I të dispozitivit në organet kompetente kadastrale.

III.DETYROHET I padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës paditësve t'ua paguaje shumën totale të shpenzimeve prej 1,140 euro dhe atë: në emër të shpenzimeve gjyqësore sipas numrit C.nr. 367/10, shumën prej 520 euro, në emër të 1 seancë gjyqësore në procedurë ri gjyqësore shumën prej 270 euro, në emër të hartimit të ekspertizës shumën prej 350 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën paralajmërimin e përmbarimit të detyrueshëm."

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, si dhe të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që lënda të kthehet në rigjykim. Me anë të kësaj anekese, pala e paditur ka kërkuar në bazë të TOAK-së shumën prej 204 euro për përpilimin e anekesës.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit me datë 30.09.2010 kanë parashtruar ankesë para gjykatës së shkallës së parë kundër të paditurit, duke kërkuar që të vërtetohet se paditësit kanë fituar të drejtën pronësore në pjesën e patundshmërisë së evidentuar në certifikatat UL-70202069-00096 ZL Sh...., V.....dhe UL-70202069-00009 ZL Sh...., V..... Në precizimin e kërkesëpadisë së datës 07.11.2013, pala paditëse ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia dhe të vërtetohet pronësia e paditësve të parcelave si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit C.nr.512/18 të datës 15.07.2021.

Me aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri C.nr.367/10 e datës 07.11.2013, gjykata e shkallës së parë kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me aktvendimin Ac.nr.706/2014 i datës 06.11.2018 kishte aprovuar ankesën e palës së paditur të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe kishte prishur lëndën duke e kthyer të njëjtën në rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.512/2018, i datës 15.07.2021, me të cilin e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në këtë çështje kontestimore juridiko- civile nuk ka qenë kontestues fakti se të gjitha palët janë pasardhës të të ndjerit T.R., kurse L.R. është pasardhës i të ndjerit Xh.R., kurse paditësit G.,F.dhe i padituri H. vëllezër të të ndjerit Xh.R.. Nuk ka qenë kontestuese as se i padituri H. është i regjistruari si pronar i vetëm i pronës kontestimore në Regjistrat kadastral, dhe se sipas ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë A.G.me datë 29.10.2013 është konstatuar se ndërgjyqësit kanë bërë ndarjen faktike të pasurisë së paluajtshme mes vete përmes një marrëdhënie gojore rreth vitit 1985. Me ndarjen faktike të kësaj pasurie të paluajtshme, palët kanë shfrytëzuar pronën të cilën ju është ndarë pa pengesë nga asnjë palë tjetër për më shumë se 20 vite.

Gjykata e shkallës së parë për marrjen e vendimit është bazuar në nenin 20 par. 1, 21, 28 par. 4, 30 par. 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhënie Pronësore Juridike, ku sipas nenit 20 par. 1 përcaktohet se: *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.”* Sipas nenit 21 përcaktohet se: *“Sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo-pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj.”* Sipas nenit 28 par. 4 përcaktohet se: *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.”* Sipas nenit 30 par. 1 dhe 2 përcaktohet se: *“1. Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues. 2. Në kohën e nevojshme për parashkrimin-fitues llogaritet edhe koha për të cilën paraardhësit e mbajtësit të tanishëm kanë mbajtur sendin si mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm, respektivisht si mbajtës me mirëbesim.”*

Duke u bazuar në dispozitat e përmendura më lart, gjykata e shkallës së parë ka ardhur në konkludim se paditësit në këtë rast kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në bazë të nenit 452 par. 1.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) , 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat

janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara te theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se: gjykata edhe pse ka dal në vendshikim për të bërë identifikimin e saktë të parcelës kadastrale - kontestuese, në të cilën paditësi ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë, gjykata nuk ka arritur që sipas përshkrimit të bërë nga paditësi, të identifikojë saktësisht se cila është parcela kadastrale- kontestuese apo pjesa e saj, në të cilën paditësi ka pretenduar se ka të drejtën e pronësisë, duke e përshkruar saktësisht shtrirjen gjeografike të saj, gjatësinë dhe gjerësinë, sa është sipërfaqja e saktë e paluajtshmërisë kontestuese dhe cila është gjendja faktike në teren lidhur me atë parcelë kadastrale - kontestuese, në fakt gjykata nuk ka konstatuar asgjë, përveç deklaratimit të autorizuarve të palëve dhe ekspertit gjeodet, gjegjësisht nuk ka konstatuar se objekt kontesti është parcela kontestuese apo një pjesë e saj, cila është shtrirja gjeografike e saj, gjatësia dhe gjerësia, sa është sipërfaqja e saktë e pjesës së paluajtshmërisë kontestuese, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në posedimin e kujt gjendet në momentin e shikimit në vend, kush aktualisht e ka në posedim, ekspertiza e ekspertëve gjeodet është e mangët dhe jo e plotë. Po ashtu në shkresat e lëndës nuk ka historiat të pronës - parcelës kontestuese, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Ky lëshim nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ka ndodhur për faktin se gjyqtari i çështjes nuk ka konstatuar gjendjen faktike në vend në mënyrë të detajuar, nuk ka kërkuar historiatin e pronës kontestuese, nuk ka kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e ekspertizës të ekspertit gjeodet sepse nëse i referohemi të njëjtës nga e njëjta rezulton se ka vetëm përshkrim të pronës e jo të dhëna të sakta për parcelën kadastrale kontestuese si: nuk ka përshkrim të gjendjes faktike në vend - nuk ka të dhëna se objekt kontesti është parcela kontestuese apo pjesa e saj, nuk ka konstatuar se parcela kontestuese në momentin e shikimit në vend çfarë kulture ka detajisht, cila është shtrirja gjeografike e saj, me cilat parcela fqinje kufizohet etj.

Përveç tjerash gjykata e shkallës së parë, nuk ka vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së dytë sipas aktvendimit Ac.nr.706/2014 të datës 06.11.2018 si rezultat i kësaj ka bërë shkelje të nenit 199 të LPK-së.

Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që të prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që fillimisht të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës, (vlerësimi i prezumimëve procedurale në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë dhe në seancën përgatitore), pastaj së bashku me palët apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertin gjeodet të dal përsëri në vend, ashtu që gjykata sipas përshkrimit të cilin do ta bëjnë paditësit rreth paluajtshmërisë kontestuese, të udhëzojë ekspertin gjeodet që të bëjë identifikimin, incizimin dhe matjen e saktë të paluajtshmërisë kontestuese.

Pas identifikimit dhe matjes së saktë e cila do të bëhet nga eksperti gjeodet, gjykata do duhet ta bëjë përshkrimin e gjendjes faktike në vend dhe pastaj sipas mendimit-raportit me shkrim të cilin eksperti gjeodet do duhej t'ia sigurojë gjykatës, gjykata e shkalles së parë nuk do duhej të kishte pengesa që padinë e paraqitur nga ana e paditësve t'ia kthej në rregullim-korrigjim, duke e ftuar paditësit që kërkesëpadinë lidhur me parcelat kadastrale - apo pjesën e saj në të cilën pretendojnë se kanë të drejtën e pronësisë, ta harmonizoj me të gjeturat e bëra nga eksperti gjeodet dhe gjykata me rastin e daljes në vendshikim. Pastaj varësisht prej rregullimit apo mos rregullimit-korrigjimit të padisë nga ana e paditësve, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, nga Zyra Komunale Kadastrale në Prishtinë, të kërkohej historiati i pronës për parcelat kontestuese, duke mos përjashtuar mundësinë e kërimit të të dhënave edhe nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, dëgjimin e dëshmitarëve eventuale, e në rast nevojë edhe ballafaqimin e tyre, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendosë në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitoj shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7061/2021, me datë 21.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v